



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika, nenit 16 ,17 c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit nr. 03/l-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe nenit 20 paragrafi.1 i Statutit të Komunës së Lipjanit, 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 31.01.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

VENDIM
PËR LIRIMIN NGA PAGESA E BORXHEVE TË QIRASË JOPROFITABILE TË
PËRFITUESVE TË BANIMIT SOCIAL

Neni 1

LIROHEN , nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile për vitin 2023 të gjithë përfituesit e banimit social që janë të vendosur në 21 banesat e ndara nga komuna, sipas Konkursit publik 1Nr.360-41414 të datës 06.07.2018 konform Vendimit përfundimtar për shpalljen e familjeve përfituese të banesave komunale sipas programit të banimit 1-360-46751 të datës 24.12.2018 .

Neni 2

Lirimi nga pagesa e borxheve për përfituesit e banimit social të cekur në nenin 1 të këtij Vendimi bëhet me qëllim të krijimit të lehtësirave financiare për këto familje me gjendje të rëndë ekonomike përshkak të situatës së rënduar në ekonominë e vendit si pasojë e rritjes së lartë të çmimeve të të gjithë artikujve elementar jetësor.

Neni 3

Lirimi nga pagesa e borxheve të qirasë joprofitabile për kategoritë e lartëcekura bëhet për vitin 2023 dhe përfshin periodën kohore 01.01.2023 deri me datën 31.12.2023.

Qiraja joprofitabile është llogaritur në bazë të formulës së përcaktuar me dispozitat e nenit 9 të Ligjit për financimin e programeve të veçanta të banimit për secilin përfitues dhe mjetet që inkasohen nga qiraja janë të hyra vetanake dhe regjistrohen në Drejtoratin për Ekonomi dhe Zhvillim në kodin 21/613/48003/50408/00000/0411 .

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Zyra e Kryetarit të Komunës – Sektori pronësor juridik.

Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

15 Nr. 360/06-5616
Lipjan, më 31.01.2023

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi

